

VENDIM
Nr. 840, datë 27.9.2013

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 833, DATË 18.9.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FUSHËS SË PËRGJEGJËSISË SHTETËRORE TË MINISTRISË SË ENERGJISË DHE INDUSTRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 833, datë 18.9.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në ndarjen I, pas fjalëve “... fushave të përgjegjësive shtetërore...” shtohen “... e të organeve të varësisë...”.

2. Pas ndarjes III shtohet ndarja IV, me këtë përmbajtje:

“IV. Në përmbushje të misionit dhe të kompetencave të saj, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka organet e varësisë, si më poshtë vijon:

a) Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN);

b) Agjencinë Kombëtare Atomime (AKA);

c) Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH);

ç) Repartin e Inspektim-Shpëtim Minierave (RISHM);

d) Inspektoratin Qendror Teknik (IQT);

dh) Sekretariati “Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse” (NTIN). Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka në varësi administrative shoqëritë dhe ndërmarrjet në likuidim që veprojnë në fushën e përgjegjësive së saj, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E SHOQËRIVE TË MEI

“Albpetrol” sh.a.	Fier
“KESH” sh.a.	Tiranë
“OST” sh.a.	Tiranë
PetrolAlba	Tiranë
“Albminiera” sh.a	Tiranë
Kombinati Energjetik	Elbasan
“Prodhim Mobilje” sh.a	Tiranë
“NPV” sh.a.	Durrës
“Trikotazhi” sh.a.	Korçë
“Prodhim Këpuca” sh.a.	Korçë
“Beratex” sh.a.	Berat
“Nimex” sh.a.	Durrës
“Prodhim kablllo” sh.a.	Shkodër
Uz 12 NI CO, në likuidim	Elbasan
Uz Superfosfatit, në likuidim	Laç
Ndërmarrja e Superfosfatit	Laç
Uz Plehrave Azotike, në likuidim	Fier

NP Çelikut	Elbasan
Nd Furnizimit Ind Miniera	Elbasan
Ndërmarrje Goma	
Fabrika e Çorapeve	
Sh.a. në likuidim	
Albakër	Tiranë
Albkromi	Tiranë